



# Ballafaqimi me ekstremizmin në një mjedis arsimor në Ballkanin Perëndimor

Autore **Zorica Mihailović** dhe **Elvira Haxhibegović**,  
Anëtare të grupit të ekspertëve të RNR në Ballkanin Perëndimor

Radicalisation Awareness Network

**RANI**   
Practitioners

**Ballafaqimi me ekstremizmin  
në një mjedis arsimor në  
Ballkanin Perëndimor**

## PARALAJMËRIM JURIDIK

Ky dokument është përgatitur për Komisionin Evropian, por i njëjti reflekton pikëpamjet vetëm të autorit, dhe Komisioni Evropian nuk mban përgjegjësi për çfardo pasoje të mundshme që mund të gjenerohet nga ripërdorimi i këtij botimi. **Më shumë informacion mbi Bashkimin Evropian mund të gjeni në faqen e internetit (<http://www.europa.eu>)**

Luksemburg: Zyra e botimeve e Bashkimit Evropian, 2023

© Bashkimi Evropian, 2023



Politika e ripërdorimit e dokumenteve të Bashkimit Evropian zbatohet sipas Vendimit të Komisionit 2011/833/EU me datë 12 dhjetor 2011 për ripërdorimin e dokumenteve të Komisionit (OJ L 330, 14.12.2011. f. 39). Nëse nuk prashihet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti është autorizuar sipas licencës Creative Commons Attribution 4.0 International (CC-BY 4.0) <https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>. Kjo nënkupton se përdorimi ose ripërdorimi lejohet me kusht që t'i jepet njohja e duhur dhe të tregohen ndryshmet e mundshme.

Lidhur me përdorimin ose riprodhimin e elementeve të cilat nuk janë në pronësi të Bashkimit Evropian, do të duhet të kërkohet leje drejtpërdrejtë nga pronari përkatës.

## Hyrje dhe konteksti

Ballkani Perëndimor është një rajon që është ende i prekur nga pasojat e konflikteve të fundit dhe nga ekstremizmi etno-nacionalist në rritje. Të rinjve shpesh u mungojnë njohuritë për fetë “tjera” dhe grupet etnike-kombëtare në komunitetet e tyre, gjë që ofron terren pjellor për intolerancë dhe armiqësi midis anëtarëve të kombësive apo feve të ndryshme. Për më tepër, kushtet e këqija socio-ekonomike, papunësia e lartë dhe standardi i ulët i jetesës janë gjithashtu karakteristika të Ballkanit Perëndimor. Përveç kësaj, ndikimi i pandemisë KOVID-19 ka krijuar rrethana që i kanë bërë të rinjtë më të ndjeshëm ndaj radikalizimit si p.sh. përhapja e teorive të konspiracionit dhe dezinformative, si dhe izolimi social.<sup>1</sup> Këto janë disa nga sfidat më të mëdha me të cilat përballet stafi i shkollave dhe të rinjtë në Ballkanin Perëndimor, të cilat mund të kontribuojnë që të rinjtë të pranojnë disa nga narrativat dhe mesazhet radikale dhe ekstremiste që i hasin në internet dhe jashtë tij. Përveç kësaj, kapacitetet e mjaftueshme institucionale në sektorin e arsimit që do të parandalonin ekstremizmin e dhunshëm në sektorin e arsimit ende nuk janë zhvilluar, e po ashtu mungon një strategji gjithëpërfshirëse për trajtimin e këtij problemi. Praktikuesit e arsimit në rajonin e Ballkanit Perëndimor kanë nevojë për mbështetje dhe udhëzime për të njohur më mirë rolin e tyre dhe për t'u marrë me ekstremizmin në shkollë.

Prandaj, objektivat e këtij punimi janë:

- të theksojë rolin e sistemit arsimor dhe të shkollave në përballjen me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm;
- të ofrojë udhëzime të përgjithshme dhe këshilla praktike se çfarë sjellje duhet pasur me nxënësit që janë të ekspozuar ndaj ideologjive ekstremiste në një mjedis shkollor;
- të ofrojë udhëzime të përgjithshme dhe këshilla praktike se si duhet trajtuar temat e ndjeshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në klasë;
- të paraqesë modelet ekzistuese për të përmirësuar të menduarit kritik dhe për të inkurajuar dialogun pozitiv midis mësuesve dhe nxënësve, duke u fokusuar në tema të ndjeshme në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm në rajon.

Audienca e synuar e këtij punimi përbëhet nga mësues dhe profesionistë të arsimit që punojnë në shkolla (me fokus në nivelin e mesëm) në Ballkanin Perëndimor.

Në fillim të punimit do të paraqesim rolin e sistemit arsimor dhe të shkollave në njohjen, parandalimin dhe trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm. Cilat janë njohuritë dhe informacionet kryesore që u nevojiten mësuesve për t'u siguruar që ata janë të përgatitur mirë për trajtimin e këtyre temave? Më pas do të diskutojmë se si mësuesit mund t'i përgjigjen narrativave dhe provokimeve ekstremiste në klasë dhe si të merren me tema të ndryshme të ndjeshme dhe të diskutueshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm. Do të paraqesim lloje të ndryshme ideologjish ekstremiste dhe lloje të ndryshme përgjigjesh dhe qasjesh pedagogjike që mësuesit mund t'ua ofrojnë nxënësve me synimin për të rritur ndërgjegjësimin dhe për të ndërtuar rezistencën ndaj radikalizimit. Gjithashtu do të diskutohet efekti i pandemisë KOVID-19 dhe i mediave sociale në radikalizimin e të rinjve. Do të jepen rekomandime dhe sugjerime për aktivitete që mund të kryhen në nivel të një shkolle të tërë, pasi P/KEDH nuk është përgjegjësi e vetme e mësuesve të veçantë. Në pjesën e dytë të punimit do të paraqesim shembuj të qasjeve/metodave ekzistuese që inkurajojnë të menduarit kritik dhe komunikimin konstruktiv si nga Bashkimi Evropian ashtu

<sup>1</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2021). Narrativat e KOVID-19 që polarizojnë.

edhe nga Ballkani Perëndimor. Kjo mund të shërbejë si bazë për edukimin e mëtejshëm të mësuesve në Ballkanin Perëndimor dhe për përmirësimin e aftësive të tyre.

## Roli i shkollave në trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm

Shkollat janë institucione kyçe për forcimin e rezistencës dhe parandalimin e të rinjve që të tërhiqen nga ideologjitë dhe organizatat radikale, sepse mësuesit janë shpesh ndër të parët që vërejnë ndryshime të mundshme në sjellje që mund të tregojnë shenja të radikalizimit. Kjo i bën mësuesit bashkëbisedues të rëndësishëm për të prekurit (d.t.th. vetë individët, të afërmit dhe miqtë e tyre).

Përveç kësaj, mësuesit janë edukatorë të trajnuar dhe ata janë në gjendje të ofrojnë një hapësirë të sigurt që mund të inkurajojë qytetarinë, të menduarit kritik dhe ndërtimin e identitetit. Kjo është linja më e mirë e mbrojtjes kundër tendencave ekstremiste që e rrezikojnë sundimin e ligjit dhe të drejtat themelore në Evropë.<sup>2</sup>

Kur bëhet fjalë për trajtimin e ekstremizmit të dhunshëm në mjedisin shkollor në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ende mungojnë strategji gjithëpërfshirëse, që do të thotë se trajtimi i kësaj çështje është çështje e përgjegjësisë individuale të mësuesit.

## Cilat njohuri dhe informacione kyçe u nevojiten mësuesve?

Ndërsa përmend mënyra të ndryshme se si qeveritë mund t'i mbështesin shkollat dhe mësuesit në parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm (P/KEDH), një punim i RNR i vitit 2019 pranoi se shkollat duhet të investojnë në trajnimin për të gjithë stafin mësimdhënës, në mënyrë që ata të jenë të pajisur për të zbuluar shenjat e radikalizimit dhe të mund të ndërhyjnë në mënyrë efektive.<sup>3</sup>

Kjo qasje e P/KEDH kërkon që mësuesit të mësojnë rreth çështjeve të diskutueshme, aspekteve fetare dhe aspekteve të tjera të diversitetit, të drejtave të njeriut, legjislacionit aktual kundër terrorizmit dhe politikave të mbrojtjes së shkollave. Ata duhet të dinë se si të identifikojnë problemet dhe se si ato lidhen me grupmosha të ndryshme dhe lloje të ndryshme të ekstremizmit.<sup>4</sup>

### **Për të forcuar rolin e mësuesit në P/KEDH, rekomandohet që mësuesit të kenë informacionin dhe njohuritë e mëposhtme:**

- Informacion për fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit
- Njohuri rreth proceseve të radikalizimit dhe treguesve të radikalizimit
- Të kuptojnë shkaqet e ndryshme të ekstremizmit të dhunshëm dhe faktorët mbrojtës
- Informacion rreth mobilizuesve/rekrutuesve kyç në nivel kombëtar, rajonal dhe global
- Njohuri rreth legjislacionit (kombëtar) dhe politikave dhe procedurave të shkollave në lidhje me mbrojtjen nga dhuna dhe diskriminimi

<sup>2</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2016). *Roli i arsimit në parandalimin e radikalizimit*.

<sup>3</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2019). *Arsimi dhe parandalimi i radikalizimit: Mënyra të ndryshme me të cilat qeveritë mund t'i mbështesin shkollat dhe mësuesit në parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm*.

<sup>4</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2017). *Udhëzues për programet e trajnimit. 'Mësues dhe staf tjetër i shkollës, efektivë dhe me vetëbesim'*.

- Njohja e burimeve shkollore kur bëhet fjalë për veprimet parandaluese.

## Pjesa 1: Udhëzime të përgjithshme

Ky seksion paraqet udhëzime të përgjithshme për mësuesit se si të trajtojnë tema të ndryshme të diskutueshme që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm dhe si t'i përgjigjen narrativave dhe provokimeve ekstremiste në klasë, duke përfshirë shqyrtimin e ndikimit të mediave sociale dhe të pandemisë KOVID-19 në narrativat ekstremiste.

### Trajtimi i temave të ndryshme që lidhen me ekstremizmin

Mësuesit shpesh sfidohen të gjejnë informacion të besueshëm dhe të mbajnë qëndrim kur trajtojnë çështje të diskutueshme<sup>5</sup> në klasë, duke përfshirë në lidhje me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm. <sup>6</sup> Kjo mund të jetë ose në përgjigje të pyetjeve spontane të nxënësve, vërejtjeve dhe diskutimeve rreth temave të tilla ose kur ligjërohet për çështje të diskutueshme. Për shembull, Stradling (1984) thotë: "Thjesht nuk është e mundur të vendosen rregulla të forta dhe të shpejta për ligjërimin e çështjeve të diskutueshme që do të zbatohen në çdo kohë. Mësuesi duhet të marrë parasysh njohuritë, vlerat dhe përvojat që nxënësit i sjellin me vete në klasë; metodat e mësimit që mbizotërojnë në lëndët e tjera; klimën e klasës dhe moshën e aftësinë e nxënësve".<sup>7</sup>

Këshilli i Evropës ofron një sërë sugjerimesh praktike për mësimit dhe çështjeve të diskutueshme. Ato lidhen me sa vijon <sup>8</sup>:

- Ndërgjegjësimin dhe vetë-reflektimin personal të mësuesve
- Ndërgjegjësimin për natyrën e çështjeve të diskutueshme dhe sfidat që ato paraqesin
- Ndërgjegjësimin për përbërjen e mjedisit të klasës dhe të shkollës
- Aftësinë për të përdorur dhe zbatuar një sërë stilesh të mësimit
- Krijimin e një atmosfere të përshtatshme në klasë dhe mbështetjen e kulturës demokratike të shkollës
- Njohjen e nxënësve me kornizat dhe strategjitë që e përfshijnë konceptin e demokracisë, strategjitë për t'u përfshirë në diskutim dhe kornizën konceptuale që do t'u ndihmojë të zgjidhin konfliktet në mënyrë jo të dhunshme
- Shmangien e rolit të "ekspertit të ditur"
- Trajnimin e nxënësve për të identifikuar paragjykimet
- Aftësinë për të planifikuar dhe menaxhuar diskutimin në mënyrë efektive
- Aftësinë për të përdorur dhe zbatuar një sërë teknikash specifike të mësimit
- Përfshirjen e aktorëve dhe mësuesve të tjerë

<sup>5</sup> Këshilli i Evropës i përcakton këto si "Çështje që zgjojnë ndjenja të forta dhe i ndajnë komunitetet dhe shoqërinë" (Kerr dhe Huddleston, 2015 : 13). Këto mund të jenë çështje të vjetra si ndarjet sektare dhe tensionet midis grupeve të ndryshme, ose çështje të kohëve të fundit si radikalizimi dhe ekstremizmi, por, ndër të tjera, edhe ngacmimi kibernetik.

<sup>6</sup> Kerr, D., dhe Huddleston, T. (Eds) (2015). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme*.

<sup>7</sup> Stradling, R., Noctor, M., Baines, B. (1984). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme*.

<sup>8</sup> Kerr, D., dhe Huddleston, T. (Eds) (2015). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme*.

RNR gjithashtu rekomandon që në klasë të diskutohet për kulturat, fenë, ideologjinë dhe identitetin. Në këto diskutime duhet çmuar diversiteti i nxënësve dhe identitetet duhet të jenë gjithëpërfshirëse, jo përjashtuese. Kur nxënësit mendojnë se identiteti i tyre është "i sulmuar", kjo është një pikënisje e mirë për të punuar me ta. Profesionistët e arsimit në shkolla ose mund të përpiqen të përballojnë dallimet ose të kërkojnë ngjashmëri dhe të përqendrohen në atë që nxënësit e kanë të përbashkët. Ideologjia e barazisë duhet të jetë pjesë e etikës shkollore.<sup>9</sup>

Duke marrë parasysh gjithë atë që u theksua më sipër, mund të konkludohet se është e rëndësishme që mësuesit të iniciojnë biseda për tema të vështira në shkolla, si p.sh. dhuna e motivuar ideologjikisht, çështjet politike, aspektet fetare dhe aspektet e tjera të diversitetit, teoritë e konspiracionit dhe të ngjashme. Në vend që të sillen si ekspertë në klasë, mësuesit duhet të ofrojnë një hapësirë të sigurt për nxënësit që të ndjehen të lirë të sfidojnë në mënyrë kritike një përmbajtje të tillë dhe mendimet e tyre.

## Ballafaqimi me idetë dhe narrativat ekstremiste në klasë

Si të reagoni kur përballeni me mendimet, qëndrimet dhe idetë e nxënësve që i miratojnë sjelljet e dhunshme, d.t.th. nxënësit që mund të jenë të cenueshëm ndaj radikalizimit? Më rrallë, mund të hasim nxënës, mendimet e të cilëve tashmë janë në përputhje me ato të grupeve ekstremiste.

Përballë këtyre sjelljeve, mësuesi sfidohet të identifikojë dhe të trajtojë këto çështje në një mënyrë të sigurt dhe të hapur. Lënia e pakontrolluar e këtyre shprehjeve mund të ushqejë narrativën ekstremiste, si dhe të rrezikojë sigurinë e nxënësve.<sup>10</sup>

Në një situatë kur një nxënës promovon besime radikale fetare ose ideologjike midis nxënësve të tjerë dhe shpërndan materiale promovuese me përmbajtje ekstremiste dhe të dhunshme, mësuesi duhet të reagojë menjëherë, sepse ekziston rreziku që jo vetëm nxënësi të radikalizohet, por edhe të ketë ndikim toksik tek shokët/shoqet e tij/saj të shkollës. Mësuesi duhet të flasë me nxënësin dhe ta pyesë se nga i ka këto pikëpamje (ose materiale propaganduese) dhe më pas t'i informojë shërbimet e shkollës, të cilat nga ana e tyre duhet të kontaktojnë dhe të punojnë me prindërit, shërbimet sociale dhe, nëse është e nevojshme, me policinë, përkatësisht nëse përmbajtja e materialit është shqetësuese, potencialisht e dëmshme ose e paligjshme.<sup>11</sup>

Punimi i RNR-së<sup>12</sup> mbi trajtimin e ekstremizmit të djathtë në klasë theksoi se kjo formë e ekstremizmit shpesh anashkalohet në strategjitë e P/KEDH. Shkollat duhet t'i kushtojnë vëmendje këtij fenomeni, sepse edhe një numër shumë i vogël i nxënësve që shprehin gjuhë të urrejtjes, mesazhe polarizuese dhe/ose pikëpamje politike ekstremiste mund të prishin klimën në një shkollë. Kur flasim me këta nxënës, mësuesit duhet të shmangin përgjithësimet ose supozimet rreth ideologjisë së perceptuar të dikujt sepse kjo mund ta ndërpresë dialogun. Nëse nxënësit bëjnë komente nga e djathta ekstreme gjatë orëve mësimore, është më mirë t'i mbani ato në klasë, madje edhe kur ndarja fizike e këtyre nxënësve nga shokët/shoqet e tyre të klasës duket si një opsion i mirë. Ndërkohë i tyre nuk është gjë tjetër veçse një zgjidhje e shpejtë që mund t'i shtyjë ata drejt grupeve të ekstremit të djathtë ku

<sup>9</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2017). *Udhëzues për programet e trajnimit. 'Mësues dhe staf tjetër i shkollës, efektivë dhe me vetëbesim'*.

<sup>9</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin, Prevent. (2015). *Manifesti për arsimin – Fuqizimi i edukatorëve dhe shkollave*.

<sup>10</sup> Gjoriq, M. (2020). Manual për njohjen, parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis nxënësve - për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme në Mal të Zi.

<sup>11</sup> Po aty.

<sup>12</sup> (RNR). (2019). *Akademia RAN EDU: Ekstremizmi i ekstremit të djathtë në klasë*.

ndihen të pranuar. Është e rëndësishme të kuptojmë se çfarë fshihet pas ndjenjave dhe mendimeve të tilla. Bërja e pyetjeve të duhura do ta nxisë të menduarit kritik. Injorimi i temave specifike nuk do të thotë që nxënësit nuk do t'i diskutojnë ato.<sup>13</sup>

Për t'u marrë me ideologjitë ekstremiste në klasë, është e rëndësishme të zhvillohen aftësitë e mësuesit për zgjidhjen konstruktive të konflikteve dhe aftësitë e komunikimit si p.sh. komunikimi i sigurt/me vetëbesim. Kjo është veçanërisht e rëndësishme në situatat kur nxënësi ushtron dhunë. Në rrethana të tilla, është e rëndësishme që nxënësit të përfshihen në diskutim dhe të kuptojnë shkaqet dhe proceset e përshkallëzimit të konfliktit që çon në përdorimin e dhunës. Pas dhunës së bashkëmohatarëve ose çdo rasti tjetër të papranueshëm shoqëror në shkollë, është e rëndësishme të shfrytëzohet rasti dhe të përfshihen pjesëmarrësit e drejtpërdrejtë në këto ngjarje në aktivitete të përgatitura me kujdes për t'i ndihmuar ata të njohin dhe të kapërcejnë reagimet e papërshtatshme në situata krize.<sup>14</sup>

Gjatë trajtimit të çështjeve të ekstremizmit të dhunshëm në klasë, është e rëndësishme të inkurajohet vetë-reflektimi dhe veprimet e menduara mirë mes mësuesve, d.t.th. të inkurajohen të mendojnë se si besimet dhe vlerat e tyre personale ndikojnë në pikëpamjet e tyre profesionale rreth materialit të diskutueshëm dhe trajtimin e tij. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm dhe të ndjeshëm ndaj mënyrës se si përvoja e tyre personale në lidhje me këto tema mund të ndikojë në mënyrën se si i trajtojnë këto tema në klasë.<sup>15</sup>

## Ndikimi i mediave sociale

Mediat sociale ofrojnë një terren pjellor që ekstremistët të rekrutojnë anëtarë të rinj. Mësuesit duhet të jenë të vetëdijshëm për platformat e ndryshme në internet që i përdorin nxënësit dhe të rrisin ndërgjegjësimin e tyre për rrezikun e mundshëm, si dhe të stimulojnë rezistencën dhe të menduarit kritik.

Mësuesit duhet të jenë të informuar mirë për kërcënimet e internetit kur bëhet fjalë për rekrutimin e të rinjve për grupet ekstremiste: si funksionon propaganda ekstremiste në internet, cilat janë mesazhet më të zakonshme që ekstremistët i dërgojnë në internet, si ekstremistët rekrutojnë të rinj në internet, dhe ata duhet t'ua paraqesin gjetjet e tyre nxënësve. Nëse nuk kanë njohuri të mjaftueshme në këtë fushë, ata mund të ftojnë një ekspert për t'u shpjeguar në mënyrë krijuese nxënësve se si duhet të sillen në hapësirën online dhe të njohin ndikimin e grupeve ekstremiste. Në këtë mënyrë, ata do të ndërtojnë një kulturë të sjelljes së sigurt në internet midis nxënësve të tyre.<sup>16</sup>

Mësuesit mund të përdorin gjithashtu materiale në internet për të filluar një bisedë me nxënësit e tyre rreth nevojës për t'iu qasur në mënyrë kritike përmbajtjes në internet - veçanërisht në mediat sociale.<sup>17</sup> Dimensioni online i radikalizimit në Ballkanin Perëndimor mbetet pak i kuptuar.<sup>18</sup> Veçanërisht shqetësuese është përhapja e narrativave ekstremiste të krahut të djathtë. Kjo përfshin përhapjen e gjuhës së urrejtjes dhe lajmeve të rreme,

<sup>13</sup> Kerr, D., dhe Huddleston, T. (Eds) (2015). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme*.

<sup>14</sup> Gjorij, M. (2020). *Manual për njohjen, parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis nxënësve - për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme në Mal të Zi*.<sup>15</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin, Prevent. (2015). *Manifesti për arsimin – Fuqizimi i edukatorëve dhe shkollave*.

<sup>16</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2019). *Akademia RAN EDU: Ekstremizmi i ekstremit të djathtë në klasë*.

<sup>17</sup> Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2021). *Narrativat e COVID-19 që polarizojnë*.

<sup>18</sup> RNR në Ballkanin Perëndimor. (2022) *Radikalizimi online dhe qasjet ndaj P/KEDH në Ballkanin Perëndimor*, Takim rajonal me përmasa të vogla 16 qershor 2022. [shto lidhjen].



pjesëmarrjen në sulme aktive në internet ndaj kundërshtarëve politikë ("trolling") dhe diskutimin dhe shkëmbimin e pikëpamjeve ekstremiste. Nuk është gjithmonë e lehtë për praktikuesit (duke përfshirë mësuesit) të kuptojnë se çfarë po ndodh, sepse nxënësit përdorin gjuhë dhe fjalor të koduar. Analizimi dhe kuptimi i mesazheve të së djathtës ekstreme në internet është sfidues sepse ato mund të paraqiten si shaka për të maskuar gjuhën e urrejtjes ose idetë e dhunshme. Të rinjtë shpesh përdorin meme që mund të jenë të paqarta dhe rekomandohet që mësuesit t'i marrin parasysh këto dhe fenomene të tjera në internet. Nxënësit mund të mos jenë gjithmonë të vetëdijshëm për mesazhet që fshihen pas përmbajtjes provokuese që po shpërndahet. Kjo ofron mundësi për diskutim, ndërkohë që analiza e fenomeneve të tilla mund të shërbejë si pjesë e ndërtimit të aftësive për edukim mediatik.<sup>19</sup>

## Pandemia e KOVID-19 dhe narrativet ekstremiste

Aktualisht po përballemi me sfida në lidhje me parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm që u shfaq gjatë pandemisë KOVID-19. Për shkak të pandemisë u krijuan rrethana që i bënë të rinjtë më të ndjeshëm ndaj radikalizimit në formën e përhapjes së dezinformatave, teorive të konspiracionit, rritjes së ndikimit të mediave sociale dhe izolimit social të të rinjve.

Një punim përfundimtar i paradokohshëm i RNR-së<sup>20</sup> që synon të ndihmojë mësuesit të flasin rreth narrativeve polarizuese në lidhje me KOVID-19, e njeh rëndësinë e një qasjeje krijuese ndaj informacionit në mënyrë që nxënësit të mund të vlerësojnë bindjet dhe argumentet e tyre në lidhje me KOVID-19. Praktikuesit e RNR-së kanë deklaruar se gjatë diskutimeve me nxënësit, të rëndësishme janë konceptet e tilla si faktet dhe opinionet, besueshmëria e medias dhe argumentimi. Rekomandohet që nxënësit të mendojnë vërtet se nga vjen informacioni, të vënë në dyshim burimet e tyre dhe të mos i besojnë gjithçkaje që hasin në mediat sociale.

### Kur përballen me P/KEDH, mësuesit duhet të synojnë:

1. Të informojnë dhe të ndërgjegjësojnë nxënësit për rreziqet e ekstremizmit
2. Të zhvillojnë të menduarit kritik të nxënësve
3. Të edukojnë të rinjtë për vlerat demokratike, tolerancën politike, fetare dhe etnike
4. Të sigurojnë një hapësirë të sigurt për dialog rreth temave të vështira dhe të diskutueshme në klasë.
5. Të ofrojnë narrative alternative ndaj propagandës dhe pikëpamjeve ekstremiste ndaj botës
6. Të forcojnë edukimin mediatik të nxënësve
7. Të ndërtojnë një kulturë të sigurt në internet

Kur bëhet fjalë për teoritë konspirative, strategjitë e depersonalizimit dhe të distancimit mund të jenë metoda efikase të mësimdhënies. Kur ka një çështje veçanërisht të ndjeshme, mund të jetë më e sigurt që asaj t'i qasemi drejtpërdrejt. Një shembull i një strategjie të tillë është të ligjërohet për teoritë e konspiracionit që kanë ekzistuar në të kaluarën. Në këtë mënyrë, nxënësit do të jenë më pak të përfshirë emocionalisht me komplotin (d.t.th. të depersonalizuar) dhe më të hapur për diskutim, për të menduarit kritik dhe për këndvështrime të ndryshme. Këto strategji ndihmojnë në parandalimin që temat shpërthyes të dalin jashtë kontrollit dhe u mundësojnë nxënësve t'i lënë anësh paragjykimet dhe supozimet e tyre fillestare dhe të bëhen më të hapur ndaj kompleksitetit të temës që e diskutojnë.

### Kur përballen me P/KEDH, shkollat duhet të synojnë:

1. Të krijojnë një mjedis shkollor të mbrojtur dhe të sigurt për të gjithë nxënësit
2. Të promovojnë tolerancën dhe përfshirjen sociale
3. Të parandalojnë dhunën dhe diskriminimin mes nxënësve
4. Të rrisin ndërgjegjësimin e punonjësve për rreziqet e ekstremizmit të dhunshëm
5. Të ndërtojnë kapacitetin e stafit për zgjidhjen konstruktive të konflikteve
6. Të krijojnë partneritete me organizata joqeveritare, ekspertë të jashtëm dhe përfaqësues të bashkësive fetare

## Pjesa 2: Qasjet dhe metodat ekzistuese për mësuesit dhe shkollat në P/KEDH

Ky kapitull do të paraqesë qasjet që janë të arritshme dhe relevante, si dhe metodat që mund të përdoren për **praktikuesit e arsimit që aspirojnë për vetë-edukim të mëtejshëm dhe përmirësim të aftësive të tyre në fushën e P/KEDH**. U zgjodhën praktika jo vetëm nga rajoni i Ballkanit Perëndimor, por edhe nga BE-ja, duke pasur parasysh se sigurisht që ka shumë projekte më të rëndësishme në këtë fushë, të cilat nuk mund të paraqiten të gjitha në këtë punim.

Puna parandaluese në fushën e arsimit në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin që mund të çojë në EDH ose terrorizëm mund të ndahet në dy kategori:

1. Parandalimi i orientuar drejt mësuesve/praktikuesve të arsimit dhe dallimi i tre llojeve të veprimeve/roleve:
  - a. Programet e ngritjes së kapaciteteve për mësuesit/praktikuesit e arsimit:
    - i. Trajnimi gjatë punës për stafin pedagogjik të shkollës
    - ii. Trajnime shumë-sektoriale me partnerë të tjerë socialë (punonjës socialë, punonjës shëndetësorë, punonjës me të rinjtë, etj.)
  - b. Vizita studimore si me stafin arsimor ashtu edhe me partnerët përkatës social
  - c. Angazhimi i mësuesve në një ekip lokal ndërsektorial të P/KEDH
2. Parandalimi i synuar në shkolla/institucione përbëhet nga dy lloje masash:
  - a. Shkollat që veprojnë si qendra komunitare dhe krijojnë hapësira dhe punëtori të dedikuara

- b. Shkollat që marrin një rol udhëheqës në punën e P/KEDH në komunitetin e tyre lokal

Para se të fillojmë të prezantojmë praktikatat e zgjedhura frymëzuese, vlen të përmendet se hapi i parë në planifikimin e çdo ndërhyrjeje në P/KEDH në mjedisin arsimor duhet të jetë njohja e dy parimeve kryesore:

- Parimi "Mos bëj dëm" i përgjigjet pyetjes: A do të bëj më shumë dëm sesa mirë me ndërhyrjen time?
- "Qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë" i përgjigjet pyetjes: A i kam përfshirë të gjithë partnerët përkatës në planifikimin ose zbatimin e ndërhyrjes sime?

Është e rëndësishme të mbani mend se në punën parandaluese, praktikuesit nuk janë vetëm. Mësuesit, menaxhmenti i shkollës dhe praktikuesit e arsimit kanë aleatë të shumtë. Ata që kanë dëshmuar se janë shumë të denjë në Ballkanin Perëndimor janë praktikuesit nga shoqëria civile. Është shumë e këshillueshme që të përdoren të gjitha burimet e disponueshme në nivel lokal, sepse në rastin e OSHC-ve, ato kanë zhvilluar shumë shpesh programe trajnimi për mësuesit dhe aktivitete parandaluese për nxënësit që janë lehtësisht të disponueshme, ose që mund të mbështesin shpejt qasjet shumë-sektoriale të përshtatura për një shkollë, klasë apo një të ri/re konkret/e. Prandaj, është e rëndësishme t'u drejtohem praktikuesve të tjerë të P/KEDH siç janë OSHC-të që zhvillojnë struktura dhe qasje në këtë fushë.

## Praktika të orientuara drejt mësuesve dhe praktikuesve të arsimit

### Trajnimi gjatë punës për mësuesit

Në rajonin e Ballkanit Perëndimor, ka një sërë kursesh të trajnimit të mësuesve për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm që tashmë janë zhvilluar si pjesë e zhvillimit profesional për mësuesit në nivel shkolle. Të gjitha ato janë testuar dhe miratuar nga Ministritë e Arsimit në Ballkanin Perëndimor. Një numër në rritje i ofruesve të akredituar të trajnimeve aktualisht po zhvillojnë më shumë përmbajtje, duke e testuar atë ose duke pritur për akreditim. Në Mal të Zi, për shembull, ekzistojnë dy programe të akredituara të trajnimit për P/KEDH<sup>21</sup> që janë të disponueshme për të gjithë mësuesit e shkollave, si dhe për nxënësit e shkollave të mesme dhe të shkollave profesionale. Zhvillimi profesional për mësuesit, i cili kërkohet me ligj në të gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor, u mundëson mësuesve të ndjekin trajnime mbi tendencat aktuale në arsim, si dhe për shumë tendenca sociale, të tilla si ekstremizmi i dhunshëm, gjuha e urrejtjes dhe ngacmimi kibernetik. Këto janë materialet më të fundit të artit të përshtatura për BP6. Trajnimi i fundit në Mal të Zi çoi në krijimin e një plani veprimi për P/KEDH në nivel shkolle<sup>22</sup>. Aktivitetet në nivel shkolle përfshinin një sërë aktiviteteve si punëtori, trajnime të edukatorëve kolegë, punë me parlamentet e nxënësve, vizita ndërshkollore të nxënësve, shfaqje artistike, vizita në qendrat lokale të imigracionit, etj. Për mësuesit dhe praktikantët e interesuar, informacione të mëtejshme mbi të gjitha kurset dhe programet e akredituara të trajnimit të mësuesve për P/KEDH mund të merren kur të kontaktohen ministritë përkatëse të arsimit në vendet e tyre.

<sup>21</sup> Katalogu i programeve të akredituara për trajnim për zhvillimin profesional të mësuesve për vitin 2020 në Mal të Zi  
<https://cso.gov.me/ResourceManager/FileDownload.aspx?rid=417057&rType=2&file=Katalog%20programa%20c 20usavrsavanja.docx> faqe 281 dhe 285. Vizita e fundit më 18.08.2022.

<sup>22</sup> E publikim dhe artikull <https://djecarnegore.me/kole-ka0-resurs-za-prevciju-i-suzbijanje-govora-mrnje-ekstremi>

## Trajnime shumë-sektoriale me partnerë të tjerë socialë (punonjës socialë dhe shëndetësorë, punonjës me të rinjtë, etj.)

Në Kosovë, trajnimi i financuar nga BE-ja "Së bashku për të parandaluar dhe luftuar ekstremizmin e dhunshëm"<sup>23</sup> është realizuar në 7 rajone nga viti 2020 deri në vitin 2022. Këtu, praktikuesit e arsimit takuan përfaqësues të OShC-ve, imamë të Bashkësisë Islame, njerëz të biznesit, nxënës, aktivistë të rinj, praktikues të tjerë të arsimit, mësues në pension dhe zyrtarë komunalë. Kështu, qasja e përfshirjes së gjithë shoqërisë u bë e dukshme edhe përmes një përvoje të përbashkët të të mësuarit.

Mësuesit e vlerësuan veçanërisht përvojën praktike përmes së cilës ata mësuan dhe praktikuan planifikimin e përbashkët në P/KEDH. Modeli më i zakonshëm i planifikimit të përbashkët është *modeli i ndërveprimit shkollë-prind-polici*, i shtjelluar më poshtë si shembull, i cili është testuar në qytetin e Gjilanit në Kosovë, ku disa raste janë trajtuar me sukses, edhe atë janë identifikuar persona në rrezik ose të cenueshëm ndaj ekstremizmit, si dhe është lehtësuar puna e disa institucioneve dhe agjencive të përfshira. Në këto raste, rastet e identikuara dhe të regjistruara të personave të arrestuar janë trajtuar nga Mekanizmi Referues (MR), një pilot projekt në Komunën e Gjilanit. MR në Komunën e Gjilanit shërben për identifikimin e hershëm të personave në rrezik ose të cenueshëm ndaj radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe për të lehtësuar punën e të gjitha institucioneve dhe agjencive që mund të angazhohen në menaxhimin e rasteve me shumë palë të interesuara të individëve në rrezik për sjellje ekstremiste radikale ose të dhunshme.

Në Shqipëri, mësuesit dhe institucionet arsimore luajnë një rol vendimtar si pjesë e një qasjeje shumësektoriale në mbrojtjen e fëmijëve si anëtarë më të cenueshëm të shoqërisë sonë, si dhe në parandalimin dhe risocializimin e fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit.<sup>24</sup> Në një proces të gjatë rehabilitimi që kërkon përfshirjen e disa institucioneve shtetërore, të komunitetit dhe shoqërisë civile, institucioneve fetare apo strukturave të tjera shoqërore, zbatohet një qasje që përfshin të gjithë shoqërinë.

Kjo qasje e përbashkët i ka dimensionet kryesore të mëposhtme:

- Parandalimi i EDH në shkolla nëpërmjet modelit Shkolla si Qendër Komunitare (SHQK), i cili mbështetet në qasjen bashkëpunuese, shumëpalëshe për sa i përket përfshirjes dhe përgjegjësisë të përbashkëta të të gjithë aktorëve, gjë që e bën atë një model unik të funksionimit të deritanishëm të qasjes SHQK në Shqipëri. Modeli SHQK (i prezantuar për herë të parë nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim - nën mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Shqipëri) integron disa aktivitete të organizuara nga shkolla, në bashkëpunim me aktorë të tjerë vendorë, si institucionet e qeverisjes vendore dhe agjencitë vendore të zbatimit të ligjit. Çdo vit, shkollat që janë pjesë e rrjetit të SHQK-së në Shqipëri, hartojnë "Planin Vjetor të SHQK" të tyre dhe aktivitetet e tij koordinohen nga mësuesi-koordinator i SHQK-së (si pikë kontakti e shkollës për P/KEDH). Disa nga aktivitetet e organizuara në kuadër të këtij plani janë:
  - 1- Takime diskutimi midis prindërve, mësuesve dhe psikologëve/punonjësve socialë të shkollës për rolin e shërbimeve psiko-sociale për nxënësit dhe thyerja e "tabuve" në marrëdhënien individ-psikolog.
  - 2- Takime të hapura mes nxënësve, të rinjve në komunitet dhe punonjësve të shërbimit shëndetësor për çështje të ndryshme të kujdesit shëndetësor,
  - 3- Aktivitete sportive mes nxënësve të shkollave të mesme dhe mes nxënësve të shkollave të ndryshme të komuniteteve,
  - 4- Takime periodike mes nxënësve dhe policisë vendore.
  - 5- Takime periodike mes nxënësve/të rinjve dhe bashkive/komunave me synim rritjen e përfshirjes së të rinjve në vendimmarrjen vendore.

<sup>23</sup> OJQ "Partners Kosova" - Qendra për Menaxhimin e Konfliktëve, <http://partnerskosova.org/>

<sup>24</sup> Intervistë me ekspertin e P/KEDH, znj. Dalina Jashari.

- Riintegrimi i fëmijëve të kthyer nga zonat e konfliktit nëpërmjet zhvillimit të programeve speciale arsimore për këta fëmijë në shkollat publike, në mënyrë që ata të integrohen në nivelin arsimor duke u bazuar në njohuritë e tyre dhe të marrin trajtim mjekësor/psikosocial duke u bazuar në vlerësimet/ekzaminimet e kryera gjatë fazës së kthimit dhe monitorimi i vazhdueshëm i aftësive të tyre sociale apo i shëndetit psikosocial.

## Programe shtesë për mësuesit dhe praktikuesit e arsimit

Është gjithashtu e mundur dhe shumë e këshillueshme që mësuesit të pyesin për thirrjet e hapura dhe të vazhdueshme për programet e ngritjes së kapaciteteve, të tilla si kurset e trajnimit Liderët kundër Intolerancës dhe Ekstremizmit të Dhunshëm (LIVE)<sup>25</sup> për liderët e komunitetit të udhëhequra nga Divizioni i Kërcënimeve Transnacionale i OSBE-së në rajon. LIVE synon të forcojë kuptimin e pjesëmarrësve për ekstremizmin e dhunshëm dhe të mësojë metoda në përputhje me të drejtat e njeriut për ta parandaluar dhe luftuar atë. Përveç kësaj, trajnimet u ofrojnë pjesëmarrësve aftësitë përkatëse për të trajtuar manifestimet lokale të ekstremizmit të dhunshëm dhe për të zhvilluar idetë e tyre për veprim, me fokus në parandalimin, zgjidhjen e konflikteve, të menduarit kritik dhe komunikimin strategjik. Ai gjithashtu i forcon njohuritë dhe aftësinë e pjesëmarrësve për të punuar me aktorë të tjerë, duke përfshirë agjencitë e zbatimit të ligjit dhe agjenci të tjera. Për më tepër, moduli i mësimit elektronik për praktikuesit i RNR-së për trajtimin e radikalizimit dhe polarizimit në klasë ofron një burim mësues sipas kërkesës për mësuesit, stafin arsimor dhe punonjësit socialë të punësuar në shkollë për të identifikuar dhe trajtuar dinamikën e radikalizimit dhe polarizimit në mjediset arsimore.

## Praktikat që i synojnë shkollat

Shkollat dhe institucionet arsimore në rajonin e Ballkanit Perëndimor luajnë një rol kyç kur bëhet fjalë për P/KEDH, siç u theksua më herët. Ky seksion fokusohet në praktikat e mira ku jo vetëm mësuesit e veçantë mund të angazhohen në punën parandaluese, por e gjithë shkolla ose institucioni përkatës mund t'i mbështesë këto përpjekje.

## Shkollat si qendra komunitare

Kjo është një qasje interesante për parandalimin e EDH-së në kontekstin e arsimit në Shqipëri. Njëzet e dy shkolla të mesme të përgjithshme janë përfshirë në qasjen shumësektoriale "Shkolla si Qendër Komunitare" (SHQK) deri në prill të vitit 2022, e cila është zbatuar që nga viti 2017, si pjesë e projektit të vazhdueshëm të Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDN) për të krijuar komunitetet rezistente ndaj ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri.<sup>26</sup>

Praktikat kryesore të SHQK-së në nivel vendor janë:

- Krijimi dhe funksionimi i Grupit Këshillimor të Shkollës si Qendër Komunitare duke përfshirë të gjitha palët e interesuara në nivel vendor - shkollën, komunën, policinë, këshillin e prindërve, nxënësit, komunitetin fetar.
- Hartimi i planit të aktiviteteve për SHQK-në duke u bazuar në një metodologji gjithëpërfshirëse dhe në koordinim të ngushtë me palët e interesuara në shkollë (nxënësit, mësuesit, prindërit), komunitetin dhe policinë. Plani bazohet në ndërveprimin shkollë-komunitet-polici për të fuqizuar të rinjtë dhe për të promovuar aktivizmin e tyre në komunitet.

<sup>25</sup> <https://www.osce.org/node/476476>

<sup>26</sup> <https://shkollaimo.org/> dhe <https://idmalbania.org/scc-beyond-school-framework/>

- Mbështetja e krijimit të klasave shumëfunktionale në shkolla, të pajisura me mobilje, kompjuterë dhe një bibliotekë me shumë libra të nevojshëm për nxënësit, por edhe për të rinjtë dhe komunitetin.
- Përfshirja e të rinjve në proceset vendimmarrëse në nivel vendor nëpërmjet pjesëmarrjes në mbledhjet e këshillit të komunitetit, duke mundësuar më shumë ndërveprim të të rinjve me përfaqësuesit e pushtetit vendor.

Mësimet e nxjerra janë:

Modeli “Shkolla si Qendër Komunitare” në vend ka treguar se zbatimi i këtij modeli ka qenë i kufizuar dhe vetëm si përgjegjësi e shkollës, veçanërisht përgjegjësi e stafit pedagogjik dhe e nxënësve, ku nismat e ndërmarra deri tani kanë qenë në masë të madhe të bazuara në projekte jashtëshkollore të lëndëve të caktuara shkollore. Përvoja ka treguar se mungesa e zbatimit të suksesshëm të modelit “Shkolla si Qendër Komunitare” qëndron pikërisht në nivelin e përfshirjes së numrit të aktorëve vendorë. Si i tillë, “Shkolla si Qendër Komunitare” nuk duhet të konsiderohet si një model ku përgjegjësia e vetme për zbatimin e saj bie mbi institucionin arsimor. Në këtë drejtim, këto projekte ndihmuan disa aktorë vendorë që të angazhohen në aktivitetet e SHQK-së, si:

Komunat e synuara u inkurajuan të angazhohen në përpjekjet e P/KEDH duke u ofruar atyre një qasje të strukturuar dhe të koordinuar që inkurajon bashkëpunimin dhe angazhimin reciprok. Për më tepër, njësitë e qeverisjes vendore u inkurajuan të krijojnë partneritete afatgjatë me aktorë të ndryshëm (veçanërisht me agjencitë vendore të zbatimit të ligjit) për të adresuar nevojat e komunitetit.

Angazhimi i policisë në aktivitete gjatë zbatimit të projektit është shumë i rëndësishëm pasi adreson disa nga sfidat me të cilat përballen këto institucione në nivel vendor, veçanërisht lidhur me besimin e ulët të qytetarëve, njohuritë e ulëta dhe ndërveprimin me komunitetin lokal, sidomos me të rinjtë, prindërit dhe mësuesit e shkollave të mesme të synuara në komunat e synuara.

Komuniteti i biznesit lokal - përvoja nga projektet tregon se komuniteti i biznesit është ndër më të neglizhuarit. Në këtë drejtim, modeli SHQK kontribuon në përfshirjen e komunitetit të biznesit lokal duke synuar t'i kushtojë vëmendje nevojës për aftësi profesionale tek të rinjtë, të cilat u përgjigjen edhe nevojave të bizneseve lokale për punonjës të kualifikuar.

Komunitetet rinore në bashkitë e largëta të Shqipërisë përballen me disa çështje sfiduese si mungesa e mundësive/infrastrukturës për t'u përfshirë në aktivitete sportive dhe kulturore; diskriminimi në bazë të origjinës së tyre, paaftësisë, gjinisë ose besimit fetar; mungesa e shembujve për t'u ndjekur që ndikojnë në jetën e tyre në shoqëri; mungesa e përfshirjes në vendimmarrjen vendore; mungesa e bashkëpunimit dhe komunikimit ndërmjet: nxënësve-mësuesve, nxënësve-prindërve, nxënësve-psikologut/punonjësit social brenda institucioneve arsimore. Nën këtë sfond, aktivitetet sipas modelit SHQK përqendrohen në rritjen e njohurive, ndërgjegjësimin dhe pronësinë lokale të komuniteteve rinore lokale për sa i përket çështjeve kyçe të rëndësishme që lidhen me rezistencën e komunitetit, të tilla si: përfshirja e komunitetit, vullnetarizmi, zgjidhja e problemeve dhe ndjeshmëria, llogaridhënia institucionale, bizneset sociale dhe shfrytëzimi i burimeve vendore etj.

Shkollat jo vetëm që mund të marrin rolin e një qendre, por më shumë se kaq, në kushtet e duhura, ato mund të marrin një pozicion kyç dhe të zhvillohen si një burim thelbësor në parandalimin e gjuhës së urrejtjes, radikalizimit dhe ekstremizmit. Për shembull, iniciatorët e një programi të ngjashëm (OJQ dhe Shoqata e Pedagogëve) në Malin e Zi<sup>27</sup> zgjedhën një qasje pjesëmarrëse, duke i inkuadruar të gjithë aktorët përkatës, duke përfshirë të rinjtë, në përpunimin e programit, i cili realizohet sikurse planet e veprimit të shkollave të përmendura më sipër. Kjo çoi veçanërisht në një komponent të ri të rrejtëzimit me shkollat me qasje të ndryshme pedagogjike dhe në menaxhimin e tyre. Ky ishte një hap i thjeshtë që ndihmoi

<sup>27</sup> <https://djecacrnegore.me/data/163/Publikacija-%C5%A0KOLE-KAO-RESURS-ZA-PREVENCIJU-I-SUZBIJANJE-GM-E-i-R.pdf>



jashtëzakonisht mësuesit dhe menaxhmentin e shkollave në zhvillimin e programeve të suksesshme parandaluese dhe i mbështeti ata në metodat e tyre të rishikimit nga kolegët duke mësuar nga përvojat e njëri-tjetrit dhe duke promovuar kështu përmirësime. Përmes këtij projekti, shkollat kanë zhvilluar plane veprimi për P/KEDH dhe parandalimin e gjuhës së urrejtjes me mbështetjen e mentorëve. Në këtë mënyrë, krijohen plane veprimi shkollore të përshtatura, të pasura me aktivitete dhe gjithëpërfshirëse në të gjithë Malin e Zi.

Dizajni i projektit përfshinte edukimin, aktivitetet për ngritjen e kapaciteteve dhe rrjetëzimin në nivele të ndryshme: stafi profesional mbështetës i shkollës (pedagogët dhe psikologët), mësuesit dhe nxënësit në komunitetet e synuara. Stafi i shkollës dhe mësuesit e trajnuar gjatë kësaj faze të projektit u bashkuan me shkollat e tjera dhe përmes aktiviteteve vijuese të mentoruara, hartuan dhe zbatuan iniciativa të ndryshme të vogla komunitare, si punëtori, vizita në qendrat vendore të imigracionit, vizita të nxënësve në shkolla të tjera, shfaqje shkollore. Programi i trajnimit për mësuesit është akredituar dhe përfshirë në trajnimin e mësuesve profesionistë, gjë që do të sigurojë ndikim afatgjatë.

## Shembuj nga pjesë të tjera të Evropës

Përveç shumë praktikave frymëzuese nga BE-ja që mund të gjenden në [koleksionin e RNR-së](#), këtu fokusohemi në dy projekte nga Evropa Perëndimore që mund të jenë frymëzuese për praktikuesit në Ballkanin Perëndimor në punën me shkollat në të gjitha drejtimet e përmendura më sipër.

Më konkretisht, këto janë metoda që mund të përdoren nga mësuesit dhe shkollat, siç është preferenca në Evropë, por edhe nga partnerët e shoqërisë civile që do t'ju angazhonin në aktivitete mbështetëse.

## Organizatave bazë frymëzuan qasje shumë-sektoriale në Belgjikë

Belgjika, një vend që përballet me një numër disproporcional të rasteve të P/KEDH në nivel evropian - si në aspektin e popullsisë ashtu edhe në numrin absolut - që në fillim ka marrë një qasje të decentralizuar ndaj P/KEDH, me qytete pilot si Antwerp, Mechelen dhe Vilvoorde, duke zhvilluar mënyrat e veta për t'u përballur me ekstremizmin, gjë që i ka çuar pothuajse automatikisht në një qasje shumë-sektoriale bazuar në kapacitetet e organizatave nga institucione të ndryshme.

Për shembull, qyteti i Mechelen ka kryer trajnime intensive për rezistencën për mësuesit, punonjësit me të rinjtë dhe zyrtarët e parandalimit<sup>28</sup>. Në këtë mënyrë, çdo profesionist mund të trajnohet për të promovuar rezistencën tek të rinjtë. Megjithatë, programi trajnimi i trajnuesve pati një efekt pozitiv të papritur. Në të vërtetë, mësuesit që kishin marrë pjesë në trajnim zbuluan se ndiheshin më rehat në trajtimin e situatave të pasigurta më pas, gjë që e parandaloi përshkallëzimin e panevojshëm dhe mundësoi mbështetje reale për të rinjtë në çdo fazë ankesash. Projekti në Mechelen ka vendosur edhe ndihmës të mësuesve në klasa. Ata ishin kryesisht punonjës me të rinjtë, të cilët ishin më afër të rinjve sesa praktikuesit e tjerë pedagogjikë. Kjo qasje proaktive siguron që i riu i prekur të mos pësojë dëme të mëtejshme dhe që përgjigjet të mbeten proporcionale, veçanërisht duke pasur parasysh mundësinë e vazhdueshme të referimeve të rreme pozitive. Nga ana tjetër, punonjësit me të rinjtë mund t'i ndihmojnë mësuesit që t'i shikojnë situatat me të rinjtë nga këndvështrime të ndryshme. Kjo mund të jetë mbështetëse, veçanërisht në raste të vështira.

<sup>28</sup> <https://www.sensespraktijkhuis.be/specialist/bram-de-groote/>

## Hapësirat e sigurta ORPHEUS

"Parandalimi online dhe offline i radikalizimit që e pengon ekstremizmin dhe e ruan sigurinë" ([ORPHEUS](#)) është një konsorcium midis partnerëve nga Franca (Calais), Holanda (Dordrecht) dhe Anglia (Portsmouth). Financohet nga Fondi Evropian i Zhvillimit Rajonal (InterReg2Seas). Qëllimi i tij nuk është vetëm të ofrojë një vështrim efektiv se si duhet të trajtohet ekstremizmi, por edhe të zhvillohet më tej me metoda nga të gjithë sektorët dhe me të gjitha nivelet e përfshirjes.

Shumica e profesionistëve që punojnë në fushën e P/KEDH kanë funksion parandalues dhe nuk duhet t'i stigmatizojnë të rinjtë me etiketën 'EDH', por t'i fuqizojnë për t'u riintegruar në shoqëri. Megjithatë, ORPHEUS supozon se të rinjtë mund të pengohen për ta bërë këtë për shkak të ankesave. Prandaj, thelbi i projektit është krijimi i hapësirave të sigurta për të rinjtë ku problemet e tyre trajtohen në mënyrë të sigurt dhe jo stigmatizuese. Në këtë hapësirë të sigurt, çdo profesionist, qoftë mësues apo persona të jashtëm, mund t'i zhvillojë më tej aftësitë e tij ekzistuese pedagogjike, të cilat janë në përputhje me standardet evropiane për trajtimin e EDH të përmendura në pjesën e parë të këtij punimi ad hoc.

ORPHEUS u ofron profesionistëve mjete për të përmirësuar aftësitë e tyre, për t'u marrë me çështjet e diskutueshme dhe rreziqet e aktiviteteve në internet. Mjetet mund të gjenden në faqen e internetit <https://www.orpheusproject.eu> dhe përfshijnë uebinare, manuale dhe udhëzues. Një prej këtyre udhëzuesve ka të bëjë me mënyrën se si mund të përdoren mjetet në kontekste të ndryshme, duke marrë parasysh dallimet kulturore dhe dallimet në nevojat që i kanë të rinjtë.

## Vërejtje përmbyllëse

Qasjet, praktikrat dhe ndërhyrjet pedagogjike të përshkruara në këtë punim mund të mbështesin mësuesit dhe praktikuesit e arsimit në trajtimin e çështjeve të ndërlukuara që lidhen me ekstremizmin e dhunshëm në klasë. Megjithëse roli i mësuesve është vendimtar, rezultatet më të mira arrihen përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në nivel shkolle, duke përfshirë një mjedis mbështetës për të gjithë nxënësit, promovimin e tolerancës dhe përfshirjen sociale dhe partneritetet shkollë-komunitet.

Megjithëse programet, materialet dhe aktivitetet për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm nuk janë ende të disponueshme për të gjitha shkollat në Ballkanin Perëndimor, kjo analizë tregon se ka programe dhe iniciativa të caktuara që mund të ofrojnë udhëzime të dobishme për stafin e shkollës. Mësuesit dhe praktikuesit në sektorin e arsimit në Ballkanin Perëndimor kanë mundësinë të marrin njohuri për P/KEDH, kryesisht përmes projekteve të drejtuara nga organizatat e shoqërisë civile që synojnë të kuptojnë fenomenin, të kuptojnë nxitësit dhe të zhvillojnë masa parandaluese. Në një masë më të vogël, mësimet mund të nxirren edhe nga programet përkatëse që synojnë të ndihmojnë se si të menaxhohen me sukses ekipet shumë-sektoriale dhe si të formësohet roli i mësuesit në këto ekipe.

Rekomandohet që të krijohet një rrjet i praktikuesve të arsimit dhe të promovohet shkëmbimi horizontal i njohurive dhe përvojave, aktivitetet e të mësuarit nga kolegët dhe bashkimi i praktikuesve. Këto sugjerime mund të ndihmojnë në shpërndarjen e njohurive midis praktikuesve.

[Kur përballen me P/KEDH, mësuesit mund të mbështeten në gjërat e mëposhtme:](#)

Qasjet dhe burimet ekzistuese nga projektet e dëshmuara:



1. Mbështetja e jashtme nga OSHC-të, komuniteti lokal, koordinatori shtetëror për P/KEDH
2. Uebinare online, trajnime dhe mjete
3. Ndërtimi i aleancave me anëtarët e tjerë të komunitetit dhe formimi i një ekipi
4. Metodatat që bazohen në ekspertizën ekzistuese të mësuesve

Burimet dhe mjetet nga Evropa Perëndimore, të cilat, megjithëse nuk janë plotësisht të zbatueshme në kontekstin e Ballkanit Perëndimor, ofrojnë njohuri të dobishme.

Pavarësisht nga qasja e zgjedhur, ekzistojnë dy parime udhëzuese që duhet të merren parasysh përpara se të përdoret P/KEDH:

1. Ndërsa shkollat dhe stafi i tyre kanë një ndikim shumë domethënës në EDH, çdo qasje e P/KEDH është një qasje e përfshirjes së gjithë shoqërisë dhe kërkon bashkëpunim ndërsektorial, i cili nga ana tjetër mundëson ndarjen e barrës.
2. Para se të ndërmerri ndonjë veprim, merrni parasysh nëse ai do të shkaktojë ndonjë dëm. Objektivi është të mbështesim dhe të mos bëjmë dëm.

## Materiale për lexim

Filmi dokumentar “*I qëndrueshëm. Reago. Rindërto.*” është prodhuar në katër gjuhë: anglisht, në gjuhën boshnjake-malazeze-serbe, shqipe dhe maqedonase. Dokumentari ofron ide lehtësisht të arritshme se si të promovohet rezistenca kundër radikalizimit që është veçanërisht e dobishme për njerëzit e interesuar që punojnë në mjedise arsimore. Ai është ngarkuar dhe shpërndarë përmes YouTube në këto katër gjuhë dhe është në dispozicion:

- Në gjuhën boshnjake-malazeze-serbe: <https://www.youtube.com/watch?v=UKuqsa2rsAA>
- Në gjuhën maqedonase: <https://www.youtube.com/watch?v=l7CeWxoG1wA>
- Në gjuhën shqipe: [https://www.youtube.com/watch?v=Rj7C4dE\\_0Vk](https://www.youtube.com/watch?v=Rj7C4dE_0Vk)
- Në gjuhën angleze: <https://www.youtube.com/watch?v=lHYQ9N-JXF8&t=464s>

Si të parandaloni sjelljen e rrezikshme midis nxënësve: Udhëzues për aplikimin e të mësuarit ndërveprues në punëtori, Botues: Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë, janar 2022. <https://www.osce.org/mission-to-serbia/510515>

Sfondi dhe burimet për projektin ORPHEUS të disponueshme në anglisht: <https://orpheusproject.webflow.io/>

### Rreth autorëve:

**Zorica Mihailović** është një psikologe shkolle në Shkollën për Turizëm dhe Hoteleri në Beograd, Serbi. Ajo është anëtare e grupit të ekspertëve të RNR në Ballkanin Perëndimor që nga viti 2021. Ajo gjithashtu ka përvujtë në mbështetjen e zbatimit të Kornizës së Referencës së Këshillit të Evropës të Kompetencave për Kulturën Demokratike (KDK) në shkollat në Serbi.

**Elvira Haxhibegović** është Drejtoreshë Ekzekutive e Forum MNE, specialiste e komunikimit dhe punonjëse me të rinjtë me dy dekada përvujtë në fushën e të rinjve dhe të shoqërisë civile në Ballkanin Perëndimor. Ajo ka diplomë fakulteti në arsim me fokus në shkencë nga puna rinore në komunitet. Aktualisht ajo është e regjistruar në Universitetin e Vjenës për

Master Profesional në Inovacion dhe Menaxhim Social. Ajo është anëtare aktive e Ekipit Kombëtar Operativ për P/KEDH në Mal të Zi, si dhe anëtare e Ekipit të Asistencës dhe Mbështetjes për P/KEDH. Në nivel BE-Ballkani Perëndimor, ajo ishte udhëheqëse e projektit për ngritjen e kapaciteteve për aktorët e shoqërisë civile: 'Komunitetet në vend të parë!', i zbatuar në të gjitha gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor.

## Bibliografia

Coolsaet, R. (2016). *I gjithë radikalizimi është lokal: Zanafilla dhe të metat e një koncepti të paarritshëm*. (Punim i Egmont, 84). Qasja nëpërmjet <http://www.egmontinstitute.be/content/uploads/2016/05/ep84.pdf?type=pdf>.

Gjoriq, M. (2020). *Manual për njohjen, parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm midis nxënësve - për mësuesit e shkollave fillore dhe të mesme në Mal të Zi* Podgoricë: Ekipi kombëtar operacional për P/KEDH Mali i Zi. Qasja nëpërmjet <https://www.gov.me/dokumenta/434b53da-98ec-4077-8a46-e13c77c2a7c2>.

Kerr, D., dhe Huddleston, T. (Eds) (2015). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme. Paketë për zhvillim profesional për mësimdhënien efektive të çështjeve të diskutueshme e zhvilluar me pjesëmarrjen e Qipros, Irlandës, Malit të Zi, Spanjës dhe Mbretërisë së Bashkuar dhe me mbështetjen e Shqipërisë, Austrisë, Francës dhe Suedisë*. Strasburg, Francë: Keshilli i Evropës. Qasja nëpërmjet <https://edoc.coe.int/en/humanrights-democratic-citizenship-and-interculturalism/7738-teaching-controversial-issues.html>.

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2021). *Narrativat e KOVID-19 që polarizojnë*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-12/ran\\_paper\\_covid-19\\_stories\\_that\\_polarise\\_20201112\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-12/ran_paper_covid-19_stories_that_polarise_20201112_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2019). *Edukimi dhe parandalimi i radikalizimit: Mënyra të ndryshme me të cilat qeveritë mund t'i mbështesin shkollat dhe mësuesit në parandalimin/luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files\\_en?file=2019-08/ran\\_edu\\_different\\_ways\\_governments\\_can\\_support\\_schools\\_teachers\\_052019\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files_en?file=2019-08/ran_edu_different_ways_governments_can_support_schools_teachers_052019_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2019). *Takimi i RAN EDU për trajtimin e ideologjive ekstremiste të frymëzuara nga feja në shkollë*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2019-12/ran\\_edu\\_meeting\\_dealing\\_religion-inspired\\_extremist\\_ideologies\\_school\\_14-15\\_112019\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2019-12/ran_edu_meeting_dealing_religion-inspired_extremist_ideologies_school_14-15_112019_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2019). *Rishikim i punimit. Akademia RAN EDU: Ekstremizmi i ekstremit të djathtë në klasë*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files\\_en?file=2019-08/ran\\_edu\\_academy\\_far-right\\_extremism\\_in\\_classroom\\_berlin\\_13-14\\_062019\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files_en?file=2019-08/ran_edu_academy_far-right_extremism_in_classroom_berlin_13-14_062019_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin/Edu. (2017). *Udhëzues për programet e trajnimit. 'Mësues dhe staf tjetër i shkollës, efektivë dhe me vetëbesim'*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-09/ran\\_edu\\_guide\\_training\\_programmes\\_helsinki\\_01-02\\_03\\_2017\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files/2020-09/ran_edu_guide_training_programmes_helsinki_01-02_03_2017_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjësimit për Radikalizimin. (2016). *Roli i arsimit në parandalimin e radikalizimit*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files\\_en?file=2020-09/role\\_education\\_preventing\\_radicalisation\\_12122016\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/system/files_en?file=2020-09/role_education_preventing_radicalisation_12122016_en.pdf).

Rrjeti i Ndërgjegjesimit për Radikalizimin, Prevent. (2015). *Manifesti për arsimin – Fuqizimi i edukatorëve dhe shkollave*. Qasja nëpërmjet [https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-wedo/networks/radicalisation\\_awareness\\_network/docs/manifesto-for-education-empowering-educatorsand-schools\\_en.pdf](https://ec.europa.eu/home-affairs/sites/homeaffairs/files/what-wedo/networks/radicalisation_awareness_network/docs/manifesto-for-education-empowering-educatorsand-schools_en.pdf).

Rosand, E. dhe Manton, E. (2021). Mësimet e nxjerra nga parandalimi dhe lufta kundër ekstremizmit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor. RUSI. Qasja nëpërmjet [https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand\\_and\\_manton\\_newsbrief.pdf](https://www.gcerf.org/wp-content/uploads/2021/05/rosand_and_manton_newsbrief.pdf).

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. (2019). *Roli i shoqërisë civile në parandalimin dhe luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit që çon në terrorizëm: Udhëzues për Evropën Juglindore*. Qasja nëpërmjet [https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/400241\\_1.pdf](https://www.osce.org/files/f/documents/2/2/400241_1.pdf).

Stephens, W. dhe Sieckelinck, S. (2020). Të qenit rezistent ndaj radikalizimit në politikën e PEDH: ekzaminim kritik, *Studime kritike mbi terrorizmin*, 13:1, 142-165, DOI: [10.1080/17539153.2019.1658415](https://doi.org/10.1080/17539153.2019.1658415).

Stradling, R., Noctor, M., Baines, B. (1984). *Mësimdhënia e çështjeve të diskutueshme*. Londër: Edward Arnold.

Van Leuven, A. (2023). Parandalimi i frymëzuar nga provat i ekstremizmit të dhunshëm në qytetin belg të Mechelen-it: Vlerësim dhe rekomandime. Në Shahsi Jayakumar, Ed., *Perspektivat për luftën kundër ekstremizmit: ridrejtimi dhe shkëputja*. I.B.Tauris, (forthcoming).

## **GJETJA E INFORMACIONIT RRETH BE-SË**

### **Online**

Të dhëna lidhur me Bashkimin Evropian në të gjitha gjuhët zyrtare të BE-së ka në ueb-faqen e Evropës në: [https://europa.eu/european-union/index\\_en](https://europa.eu/european-union/index_en)

### **Botimet e BE-së**

Mund të shkarkoni ose të porositni publikime të BE-së falas dhe me pagesë nga: <https://op.europa.eu/en/publications>. Shumë kopje të botimeve falas mund të gjenden duke kontaktur Europe Direct ose qendrën tuaj lokale të informimit (shih [https://europa.eu/european-union/contact\\_en](https://europa.eu/european-union/contact_en)).

### **Ligjet e BE-së dhe dokumentet përkatëse**

Për qasje në të dhëna ligjore nga BE-ja, duke përfshirë të gjitha ligjet e BE-së që nga viti 1952 në të gjitha versionet në gjuhët zyrtare, shkoni në EUR-Lex në: <http://eur-lex.europa.eu>

### **Të dhëna të hapura nga BE-ja**

Portali i të dhënave të hapura të BE-së (<http://data.europa.eu/euodp/en>) siguron akses në grupet e të dhënave nga BE-ja. Të dhënat mund të shkarkohen dhe ripërdoren falas, për qëllime komerciale dhe jokomerciale.

Radicalisation Awareness Network

# RANI

## Practitioners



Publications Office  
of the European Union